



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

KABINETI I KRYETARIT / URED PREDSEDNIKA / CABINET OF THE PRESIDENT

Prishtinë, më 17 prill 2014
Ref. Nr.: KK 66/14

Z. Ismet Kabashi, Kryeprokuror i Shtetit
Prishtinë, Republika e Kosovës

Lënda: Njoftim përkitazi me moszbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI112/12

I nderuari Kryeprokuror Kabashi,

Duke shprehur konsideratën time për punën Tuaj, bashkëngjitur me këtë njoftim jua përcjell shkresën time drejtuar znj. Kada Bunjaku-Përçuku, kryetare e Gjykatës Themelore në Mitrovicë, përkitazi me moszbatimin e Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI112/12.

Me respekt

Prof. dr. Enver Hasani
Kryetar





REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

KABINETI I KRYETARIT / URED PREDSEDNIKA / CABINET OF THE PRESIDENT

Prishtinë, më 17 prill 2014

Ref. Nr.: KK 65/14

**Znj. Kada Bunjaku - Përçuku, kryetare e Gjykatës Themelore
Gjykata Themelore në Mitrovicë
Mitrovicë, Republika e Kosovës**

E nderuara kryetare Bunjaku - Përçuku,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, duke zhvilluar aktivitetin e saj sipas kompetencave të parapara me Kushtetutën e Kosovës, në procedurën e vlerësimit kushtetues të shkeljes së të drejtave të njeriut, ka pasur për objekt shqyrtimi Aktvendimin përfundimtar të Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 61/12, të 12 shkurtit 2012.

Pas shqyrtimit të kërkesës së parashtruar para saj, Gjykata Kushtetuese, në rastin KI112/12, ka konstatuar se vendimi, vlerësimi kushtetues i të cilit është kërkuar, ka rezultuar me shkelje të të drejtave të njeriut dhe, për pasojë, Gjykata Kushtetuese ka zhvlerësuar/anuluar Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë, Ac. nr. 61/12, të 12 shkurtit 2012.

Gjykata Kushtetuese ka kërkuar që Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Skenderaj, ta rishqyrtojë këtë aktvendim dhe që gjatë procedurës së rishqyrtimit të merren parasysh dhe pa asnjë rezervë të jetësohen rekomandimet dhe sugjerimet e saj dhe të eliminohen shkeljet e konstatuara nga Gjykata Kushtetuese.

Deri më sot, Gjykata Kushtetuese nuk ka marrë asnjë përgjigje nga Gjykata Themelore në Mitrovicë lidhur me hapat e ndërmarrë për ekzekutimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin KI112/12.

Me këtë rast, jua përkujtoj se Neni 116 i Kushtetutës [Efekti Juridik i Vendimeve] shprehimisht ka paraparë: **“Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës.”**

Nga sa u tha më sipër, luteni që, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e marrjes së kësaj kërkesë, ta njoftoni Gjykatën Kushtetuese lidhur me zbatimin e aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese.

Me qëllim të përmbushjes së obligimit të detyrimit kushtetues të zbatimit të vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, si në sasi, ashtu edhe në përmbajtje (neni 116.1 i Kushtetutës) për të gjitha institucionet e Kosovës, një kopje e kësaj shkrese për dijeni i dërgohet Kryeprokurorit të Shtetit, z. Kabashi.

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës mbetet e përkushtuar në realizimin e plotë të funksionit të saj të gardianit të Kushtetutës dhe të garantuesit të të drejtave të njeriut. Për realizimin e këtyre qëllimeve, Gjykata mirëpret bashkëpunimit me Gjykatën Themelore të Mitrovicës, gjithmonë në interes të respektimit të kushtetutshmërisë dhe të sundimit të ligjit.

Me respekt

Prof. dr. Enver Hasani
Kryetar

